

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çfarë konstatoi trupi gjykues?
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/aktualitet/detajet-e-verdiktit-per-ish-kreret-e-uk-se-fare-ko-i1185203
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:28:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:24:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	17599e17a0c98a7af4e01aa2c40dc1b02e47a30792d2f97ac6fa6f45f586b21f
TEKSTI	c65d5982aeadd6ebddaee0a7c0349e81a7f8cc3d6c50099ea453e08a0bc1d3b5a
PAMJA	245ca3a0772e9ed092cd9b82c6e941daaa698ff8e2008aea927703f0ae9cbdd6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f65375ea7a2bfe6c0bc0e0c95e471997097ae0f469fe4320f0283e0ee45849d3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f65375ea7a2bfe6c0bc0e0c95e471997097ae0f469fe4320f0283e0ee45849d3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çfarë konstatoi trupi gjyqësor?

Nga A2 CNN
16 Shtator 2026, 17:24 | Aktualitet



Mbi 41 muaj pas nisjes së procesit gjyqësor, Gjykata Speciale e Kosovës, me seli në Hagë, më 16 shtator i shpalli fajtorë për krime lufte katër ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK): Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin.

Pas dëshimit të 273 dëshmitarëve, dhe vlerësimit të gati 5.500 provave materiale, ata u shpallën fajtorë për katër akuzat për krime lufte: arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.

Thaçi, ish-president i Kosovës, dhe Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, u dënuan me nga 25 vjet burgim. Veseli, po ashtu ish-kryetar i Kuvendit, u dënua me 18 vjet burgim, ndërsa Selimi, ish-deputet, me 13 vjet.

Në anën tjetër, të katërt u shpallën të pafajshëm për gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit: përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë, përcjell A2.

Të pafajshëm u shpallën edhe për një numër incidentesh specifike që ishin listuar në aktakuzë, brenda akuzave për krime lufte.

Çfarë u konstatua për akuzat për krime lufte?

Sipas trupit gjyqësor, midis prillit 1998 dhe 20 qershorit 1999, anëtarë të UÇK-së privuan arbitrarisht nga liria së paku 385 persona që i akuzonin se ishin "kolaboracionistë", "spionë" apo "tradhtarë".

Në shumicën e rasteve, tha trupi gjyqësor të mërkurën, nuk kishte prova se këta persona ishin përfshirë në veprimtari kriminale, lufte apo veprimtari që do të përbënin shqetësim legjitim sigurie.

Të ndaluarit nuk u informuan zyrtarisht për arsyet e ndalimit, nuk dolën pa vonesë para një gjyqtari ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit.

Në lidhje me trajtimin e të ndaluarve, trupi gjyqësor konstatoi se të ndaluarit mbaheshin në kushte të rënda, në dhoma të mbipoplluara, pa ushqim dhe ujë të mjaftueshëm, pa kujdes shëndetësor dhe, në disa raste, të lidhur me zinxhirë ose pranga.

Gjykata konstatoi, gjithashtu, se shumë prej tyre ishin rrahur me shkelma, qyta të pushkëve, shkopinj, shufra metalike dhe mjete të tjera. Disa thuhet se u detyruan të shikonin keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë, ndërsa disa iu nënshtruan ekzekutimeve të simuluar dhe kërcënimeve për vrasje.

Në 49 raste, Gjykata konstatoi trajtim mizor, ndërsa 303 persona tha se ishin torturuar.

TE FUNDIT

Vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, DASH për A2 CNN: Mbështesim drejtësinë për të gjitha viktimat

Grenell: Kurti duhet ta shpërbëjë Gjykatës Speciale

Suedia dëbon zyrtarin iranian, përplasje diplomatike mes Stokholmit dhe Teheranit

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon SHBA: Respektojmë aktgjykimin

MË TË VIZITUARAT

Dënimi i krerëve të UÇK, PD gati rezolutën për të dënuar gjenocidin serb në K...

Trishtim dhe zhgënjim, institucionet dhe politika në Shqipëri kundër vendimeve...

Politika bëhet bashkë, PS e PD "dënojnë" Hagën: Morën vendim të turpshëm

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Në rastin e vrasjeve, trupit gjykues konstatoi se së paku 96 persona ishin vrarë nga anëtarë të UÇK-së në 12 komuna të Kosovës dhe në një lokacion në Shqipërinë veriore. Viktimat, sipas Gjykatës, ishin vrarë me armë zjarri ose kishin vdekur si pasojë e rrahjeve brutale.

Shfajësimi për krime kundër njerëzimit

Ndryshe nga krimet e luftës, për të cilat trupit gjykues gjeti përgjegjësi penale të të akuzuarve, për krimet kundër njerëzimit ai konstatoi se nuk ishin përmbushur të gjitha kushtet që kërkon ligji.

Gjykata konstatoi se anëtarë të UÇK-së kishin kryer akte dhune dhe keqtrajtimi ndaj civilëve në Kosovë dhe në disa zona të Shqipërisë veriore. Sipas saj, këto akte ishin pjesë e një sulmi të përhapur ose sistematik.

Por, për t'u cilësuar juridikisht si krime kundër njerëzimit, nuk mjafton që aktet të jenë të shumta ose të organizuara. Duhet të provohet edhe se sulmi ishte i drejtuar kundër një popullate civile. Pra, se civilët ishin shënjestër, si pjesë e një grupi të caktuar dhe jo vetëm individë të veçantë.

Pikërisht këtë element, sipas trupit gjykues, Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk arriti ta provonte përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata vlerësoi se viktimat ishin përzgjedhur kryesisht për arsye individuale – për shembull, për shkak të identitetit, veprimeve ose lidhjeve të tyre të pretenduara – dhe jo sepse i përkisnin një popullate civile që ishte shënjestruar në tërësi.

Prandaj, edhe pse Gjykata konstatoi një sulm të përhapur ose sistematik ndaj civilëve, ajo nuk gjeti të provuar elementin e nevojshëm që ai sulm të përbënte krime kundër njerëzimit. Si rrjedhojë, të katër të akuzuarit u shpallën të pafajshëm për gjashtë pikat e tilla.

Gjykata konstatoi "qëllim të përbashkët kriminal"

Trupit gjykues konstatoi se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi, së bashku me persona të tjerë në udhëheqjen e UÇK-së, kishin si qëllim pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik e institucional mbi një Kosovë të pavarur.

Sipas gjykatës, për realizimin e këtyre objektivave, ata kishin një qëndrim të përbashkët se disa persona që konsideroheshin pengesë për qëllimet e tyre duhej të "shënjestroheshin", "eliminoheshin" ose "neutralizoheshin".

Këta persona thuhet se përfshinin, ndër të tjera, anëtarë ose përfaqësues të forcave të tjera politike dhe ushtarake, veçanërisht persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), persona që konsideroheshin të lidhur me autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të komuniteteve rome dhe serbe.

Gjykata konstatoi se ky qëllim i përbashkët ishte zbatuar përmes vrasjeve, arrestimeve dhe ndalimeve pa proces të rregullt ligjor, si dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik, frikësimit dhe përdorimit të asaj që në aktgjykim quhet "luftë speciale".

Trupit gjykues tha se krimet nuk ishin rezultat vetëm i hakmarrjeve personale, bandave apo veprimeve të izoluar, por ishin pjesë e një plani që, sipas tij, ishte hartuar nga të akuzuarit dhe persona të tjerë dhe ishte zbatuar gjatë konfliktit.

Gjykata gjithashtu listoi një numër figurave të tjera të njohura të UÇK-së – Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rrustem Mustafa, Latif Gashi, Shukri Buja dhe Sabit Geci – për të cilat tha se ishin në dijeni për këtë qëllim të përbashkët kriminal dhe se kishin rënë dakord me të, si dhe kishin marrë pjesë në realizimin e tij.

Megjithatë, aktgjykimi thekson se ndaj këtyre shtatë personave nuk është bërë konstatim fajësie në këtë çështje, dhe se ata vazhdojnë të kenë të drejtën të prezumohen të pafajshëm.

Si e përcaktoi Gjykata përgjegjësinë e Thaçit, Veselit, Selimit e Krasniqit?

Gjykata konstatoi se katër të akuzuarit kishin dhënë kontribut të qenësishëm në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët dhe, mbi këtë bazë, i gjeti penalisht përgjegjës për katër krimet e luftës.

Në rastin e Thaçit, gjykata tha se ai kishte luajtur rol kyç në formulimin dhe zbatimin e

qëllimit të përbashkët, ndërsa konstatoi se kishte marrë pjesë edhe personalisht në disa prej krimeve, përfshirë rastin e Behajdin Allaqit.

Për Veselin, gjykata veçoi pozitën e tij si shef i Drejtorisë së Zbulimit të UÇK-së, organ që, sipas konstatimeve, kishte përgjegjësi për identifikimin, vëzhgimin dhe neutralizimin e personave të dyshuar si “kolaboracionistë”. Gjykata tha se ai nuk ndërmori hapa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e krimeve, megjithëse kishte dijeni për to.

Për Selimin, trupi gjykues konstatoi se ai kishte kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Gjykata vuri në dukje se pozita e tij si inspektor i përgjithshëm i UÇK-së i jepte më pak pushtet mbi anëtarët e tjerë të organizatës, krahasuar me disa prej të akuzuarve të tjerë.

Ndërsa për Krasniqin, gjykata konstatoi se ai kishte përdorur pozitën, rolin si udhëheqës, pushtetin dhe statusin e tij për zbatimin e aspekteve kriminale të qëllimit të përbashkët.

Çfarë ndodh tani?

Aktgjykimi mund të apelohej dhe avokatët e katër të dënuarve kanë paralajmëruar se do ta kundërshtojnë atë në shkallën e apelit.

Avokati i Thaçit, Pierre-Richard Prosper, e cilësoi aktgjykimin si “tallje me drejtësinë” dhe tha se mbrojtja do të kërkojë rrëzimin e tij në apel.

Ai paralajmëroi se procesi i apelit mund të zgjasë me vite./ [REL \(A2 Televizion\)](#)

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Mbretëria e Bashkuar: Vendimi të mos përdoret për të ndezur tensione



Milorad Dodik kundër vendimi për Hashim Thaçin: Duhej dënuar për krime kundër njerëzimit



Drejt tensioneve para goditjes së EULEX



Mëso lufta në Hagël Olimtori, politikan

Pas tensioneve para godines së EULEX, qytetarët protestojnë para qeverisë, hidhen gurë drejt godinës



Çfarë u provua dhe çfarë jo? Surroi: 9 pika për të kuptuar vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Nga lufta në Hagë: Çlirimtari, politikani dhe i pandehuri, 3 jetët e Hashim Thaçit




Reagimet në Prizren pas vendimit: Për çfarë luftuam, Evropa vazhdon keqtrajtimin e shqiptarëve

Latest Videos



"Ata që kanë bërë genocid asnjë nuk është dënua me kaq vite sa është dënua Hashim Thaçi"



Koci: Është rast unik që 4 të akuzuar mbahen në burg për 6 vite



"Është një vendim skandaloz, ishte cinizëm të thoje "Në emër të popullit të Kosovës"



"UÇK, UÇK" Thirrjet e qytetarëve të revoltuar poshtë zyrës së Kurtit. Edhe gurë drejt Kryeministrit

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.